

**AKT THEMELIMI DHE STATUT**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**ILLYRIAN DIGITAL Sh.p.k.**

Në Tiranë, sot në datë 22 Janar 2021

Zj.Elsa Cara, e bija e Qazimit, e dtl. 19.10.1983, lindur ne Zaisë,Mirditë dhe banuese në Rr. Selman Riza, Nd 4, H 10, Ap. 25 , Tiranë shtetase shqiptare, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e , letërnjoftimit me nr. personal I36019127Q.

Me cilësinë e ortakut të vetëm ka redaktuar këtë akt themelimi dhe statut, për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "ILLYRIAN DIGITAL" shpk, në respektim të Kodit Civil, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar.

**Neni 1**  
**Emërtimi i Shoqërisë**

- 1.1 Shoqëria e emërtuar ILLYRIAN DIGITAL Sh.p.k. (me poshtë e quajtur "Shoqëria"), është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.
- 1.2 Shoqëria është themeluar sipas Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe fiton personalitet juridik pas regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2**  
**Selia**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Bulevardi Zhan Dark, ps nr 7/210/ Nd 1 kati 2, Hyrja 7, Tiranë, Shqipëri;
- 2.2 Shoqëria mund të hapë zyra përfaqësimi, degë dhe/ose filiale dhe/ose të marrë pjesë në shoqëri të tjera, të kryejë aktivitetet në vende të tjera, qoftë brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.



#### **Neni 4 Objekti**

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në:

- Dizenjim software. Analize, projektim i arkitektures se nje sistemi software. Zhvillim dhe mirembajtje sistemesh software. Programimi i sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i te gjithe komponenteve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, modifikimet dhe mirembajtja e te gjithe komponenteve, suportu i sistemit.
- Testim software. Testim i funksionaliteteve, ngarkesca ne pune, performances, disponueshmerise dhe sigurise se sistemit software.
- Dizenjim dhe zhvillim sistemesh komunikimi. Analize, planifikim, projektim, zbatim, vendosje ne pune dhe mirembajtje e sistemeve te komunikimit te rrjeteve te pajisjeve informatike.
- Dizenjim dhe zhvillim sistemesh te sigurise. Analiza e kerkesave te sigurise se klientit, projektimi i arkitektures, instalimet dhe konfigurimet e komponenteve, vendosja ne pune, testimet e sigurise dhe mirembajtja. Zhvillim sistemesh migrimi. Transferimi i te dhenave dhe infrastruktures perkatese nga nje teknologji e vjeter ne nje teknologji te re. Permiresim sistemesh informatike. Operimi, menaxhimi, suportu i perdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik, informatik per sistemet software.
- Sherbim profesional ndaj kujdesit te klientit. Sherbim profesional i menaxhimit të projekteve. Shërbime e këshillime financiare. Grafik dezajn dhe menaxhimi rrjeteve sociale.
- Gjithashtu shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshem ne Republiken e Shqiperise.

#### **Neni 5 Kapitali**

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është 10,000 (dhjetë mijë) euro, i ndarë në 1 kuotë, vlera e të cilit zotërohet nga Ortaku i vetëm si me poshtë:
- Zj.Elsa Cara, mbajtëse i 1 (nje) kuote, e cila përfaqëson 100% të kapitalit me vlerë 10,000 euro;
- 5.2 Kuotat janë të transferueshme dhe mund të transferohen në çdo kohë në përputhje me kushtet dhe afatet që përcaktohen në ligjin shqiptar. Përgjegjësia e Ortakut shtrihet deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin e Shoqërisë.



## Neni 6 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

6.1 Në baze të ligjeve dhe dispozitave të këtij Statuti, asambleja e përgjithshme e ortakëve të Shoqërisë është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë. Ajo përfaqëson të gjithë ortakët dhe vendimet e saj, të marra në përputhje me ligjin dhe këtë Statut, janë detyruese për të gjithë ortakët, përfshirë ata që nuk marrin pjesë në votim dhe që votojnë kundër këtyre vendimeve.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të mëposhtëme:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të Shoqërisë;
- b) miratimi i ndryshimeve të statutit;
- c) emërimi e shkarkimi i anëtarëve të Keshillit Administrativ/Administratorit të Vetëm si dhe përcaktimi i kompetencave dhe shpërblimit të tyre;
- d) emërimi e shkarkimi i likuiduesve dhe Audituesve Ligjorë si dhe përcaktimi i shpërblimit të tyre;
- e) mbikëqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga Këshilli administrativ/Administratori i Vetëm, përfshirë mbikëqyrjen e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës;
- g) zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës;
- h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) caktimin e përfaqësuesit të Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj anëtarëve të Keshillit Administrativ/Administratorit të Vetëm;
- j) miratimin e riorganizimit të Shoqërisë, përfshirë bashkimin me shoqëri të tjera, ndarjen e Shoqërisë, shndërrimin e Shoqërisë si dhe prishjen e Shoqërisë;
- k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë së ortakëve.
- l) çështje të tjera të parashikuara nga Ligji apo statuti.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e Asamblesë duke patur të drejtën e votës në raport me vlerën nominale të kuotës së tij. Çdo ortak mund të përfaqësohet në vendimarrje nga një ortak tjetër, nga bashkeshorti(ja) ose nga çdo person tjetër, me kushtin që përfaqësuesit të jenë të pajisur me autorizimin për atë qëllim. Administratoret e shoqërisë nuk mund të jenë përfaqësues të ortakëve në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së ortakëve, por përfshin edhe mbledhjet me të njëjtin rend dite.

6.2 Administratori(et) sipas gjykimit të tij të lirë ose me kërkesën e një dhe/ose me shumë ortakëve të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë dhe/ose Audituesit Ligjor nëse ka, dhe/ose likuiduesit kanë të drejtë të therrasin Asamblesë e Përgjithshme të Ortakëve. Në këtë rast ortakëve duhet t'iu dërgohet një njoftim me shkrim për mbledhjen me postë elektronike (email) jo më vonë se 7 ditë përpara datës së mbledhjes, i cili thekson qëllimin, vendin dhe orën e mbledhjes.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit brenda 6 muajve nga përfundimi i vitit ushtrimor.



A handwritten signature in black ink, followed by the date '21/3' written below it.

6.3 Përveç se kur parashikohet ndryshe nga Statuti, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendos në menyre të vlefshme kur në mbledhje marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë me shume se 30% (tridhjetë përqind) të numrit total të votave dhe vendimet merren me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Për të vendosur shpërndarjen e fitimit, ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar si dhe riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve konsiderohet e mbledhur rregullisht kur janë të pranishëm ose të përfaqësuar ortakët që zotërojnë me shume se 50% (pesëdhjetë përqind) të numrit total të votave. Vendimi merret me votën pro të të paktën 75% (shtatëdhjetë e pesë) përqind të ortakëve të pranishëm.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të vendosë për shkak të mungesës së kuorumit të përcaktuar me lart, ajo mbledhet përsëri jo me vonë se 30 (tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.

#### Neni 7

#### Administrimi i Shoqërisë

- 7.1 Administrimi i Shoqërisë do të kryhet nga Administratori.
- 7.2 Administratori emërohet me vendim të Ortakëve dhe qëndron në këtë detyrë për një afat jo më të gjatë se 5 vjet. Administratori mund të rizgjidhet për të njëjtën periudhë me vendim të Ortakëve të shoqërisë.
- 7.3 Administrator i Shoqërisë do të jetë:

**Zj. Elsa Cara**, e bija e Qazimit, e dtl. 19.10.1983, lindur ne Zaisë, Mirditë dhe banuese në Rr. Selman Riza, Nd 4, H 10, Ap. 25, Tiranë shtetase shqiptare, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal I36019127Q

Administratori mund të shkarkohet me vendim të ortakëve në çdo moment për arsye të justifikuara.

- 7.4 Administratori është personalisht përgjegjës përpara Shoqërisë dhe/ose palëve të treta për dëme të shkaktuara nga shkelja e dispozitave të këtij Statuti ose të Ligjit.

#### Neni 8

#### Detyrat dhe Kompetencat e Administratorit

- 8.1 Pasuria dhe aktiviteti tregtar i Shoqërisë do të administrohen nga Administratori, i cili ka të drejtë të ushtroje të gjitha kompetencat që gjykon të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë, me përjashtim të atyre që ky statut dhe ligji i ka rezervuar Ortakëve të Shoqërisë. Administratori mund të autorizojë apo emërojë me anë të prokurës persona të tretë për kryerjen e veprimtarive dhe/ose kompetencave që i përkasin Administratorëve.
- 8.2 Kompetencat e Administratorit në lidhje me administrimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së Shoqërisë përcaktohen por pa u kufizuar, si me poshtë vijon.
- a) Të zbatojë politikat tregtare të Shoqërisë dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;



- b) Të sigurojë që Shoqëria respekton ligjin(et) e zbatueshem dhe standardet kontabel;
- c) Të kryejë të gjitha veprimet në lidhje me administrimin e veprimtarisë tregtare të Shoqërisë;
- d) Të përfaqësojë Shoqërinë kundrejt palëve të treta, entiteve publike apo private, si dhe entiteve/ose autoriteteve vendase ose të huaja;
- e) Të përgatisë dhe nënshkruajë pasqyrat financiare vjetore të Shoqërisë të cilat do të miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
- f) Të kryejë të gjitha regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme në lidhje me Shoqërinë sipas parashikimeve të ligjit në fuqi;
- g) Të raportojë Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe kryerjen e veprimtarive tregtare që mund të konsiderohen me rëndësi të veçantë për Shoqërinë;
- h) Të punësojë dhe të shkarkojë punonjës sipas politikave të shoqërisë;
- i) Të hartojë dhe të nënshkruajë deklaratat tatimore dhe çdo akt tjetër që ka lidhje me dokumentacionin që duhet të dorëzohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ose autoriteteve të tjera.
- j) të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në Statut.

#### **Neni 9 Audituesi(t) Ligjor**


Audituesi(t) ligjor do të emërohet(n) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve në rastet kur kjo është kërkesë e legjislacionit shqiptar. Riemërimi i Audituesit(ve) ligjor do të bëhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Audituesi(t) ligjor mund të shkarkohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve në rast të shkeljeve të detyrave, gabimeve dhe sjelljes jo të mirë profesionale.

#### **Neni 10 Viti Ushttrimor**

Viti Ushttrimor fillon në 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor të çdo viti. Përrjashtimisht, viti i parë ushttrimor fillon me datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe përfundon me datë 31 Dhjetor 2021.

#### **Neni 11 Shpërndarja dhe Prishja**

- 11.1 Shoqëria mund të shpërndahet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve. Shpërndarja e shoqërisë do të ndiqet nga prishja e saj.
- 11.2 Shoqëria do të ruajë personalitetin juridik, i cili do të shërbejë për qëllimet e likuidimit dhe emrin e shoqërisë do ta pasojnë fjalet “në proces likuidimi”
- 11.3 Likudatori(et) do të emërohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve. Prishja e Shoqërisë dhe emërimi i likuidatorit(ve) do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar.



**Neni 12**  
**Ligji i Zbatueshem**

- 12.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe me ligjin shqiptar.
- 12.2 Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, do të aplikohen dispozitat e ligjit shqiptar për shoqëritë tregtare.

**Neni 13**  
**Mosmarrëveshjet**

Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e këtij statuti dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet Shoqërisë dhe palëve të treta, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jenë gjykatat shqiptare.

**Neni 14**  
**Ndryshimet**

Ky statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose tërësisht dhe të zëvendësohet me një statut të ri me vendim të Asamblesë së Ortakeve.

Ky statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ILLYRIAN DIGITAL Sh.p.k. hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë secila.

**Ortaku i Vetëm**

Elsa Cara

